

VENDIM
Nr. 134, datë 8.3.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 763, DATË 12.12.2022, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHITESËS PËR NATYRË TË
VEÇANTË PUNE PËR DREJTORIN E PËRGJITHSHËM DHE NËPUNËSIT NË
NJËSITË TEKNIKE TË PËRMBAJTJES SË AUTORITETIT KOMBËTAR PËR
CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE SIGURINË KIBERNETIKE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të pikës 5/1, të nenit 10, të ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 1 e vendimit nr. 763, datë 12.12.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shtesës për natyrë të veçantë pune për drejtorin e përgjithshëm dhe nëpunësit në njësitë teknike të përmbajtjes së Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”, zëvendësohet me të njëjtin numër dhe titull që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 1

**MASA E SHITESËS PËR NATYRË TË VEÇANTË PUNE PËR DREJTORIN E
PËRGJITHSHËM DHE NËPUNËSIT E NJËSIVE TEKNIKE TË PËRMBAJTJES SË
AUTORITETIT KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE SIGURINË
KIBERNETIKE**

NR. RENDOR	POZICIONI	MASA E SHITESËS PËR NATYRË TË VEÇANTË PUNE
1	Titullar i institucionit	800 000
2	Zëvendësdyrëtor i përgjithshëm dhe dyrëtor dyrëtorie në dyrëtoritë e përmbajtjes përgjegjëse për funksionet e konformitetit të certifikimeve, qeverisjes së sigurisë kibernetike, kontrollit të masave të sigurisë kibernetike, zhvillimit strategjik, analizës së riskut, analizës së sigurisë kibernetike, monitorimit dhe reagimit të incidenteve.	280 000
3	Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes përgjegjës për funksionet e konformitetit të certifikimeve, garantimit të transaksioneve elektronike në treg, kontrollit të masave të sigurisë kibernetike, simulimit, monitorimit të thelluar, reagimit të incidenteve kibernetike, analizës së riskut, analizës së sigurisë kibernetike, menaxhimit të incidenteve kibernetike, qeverisjes së sigurisë kibernetike, mbrojtjes	220 000

	kibernetike dhe hetimit të incidenteve kibernetike	
4	Përgjegjës sektori në sektorët e përmbytjes përgjegjës për funksionet e monitorimit të jashtëm, politikave, çështjeve ligjore, analizës së indikatorëve, statistikave dhe modeleve, komunikimit, ndërgjegjësimit dhe zhvillimeve strategjike	150 000
5	Specialist në drejtoritë apo sektorët e përmbytjes përgjegjës për funksionet e konformitetit të certifikimeve, garantimit të transaksioneve elektronike në treg, kontrollit të masave të sigurisë kibernetike, simulimit, monitorimit të thelluar, reagimit të incidenteve kibernetike, analizës së riskut, analizës së sigurisë kibernetike, menaxhimit të incidenteve kibernetike, qeverisjes së sigurisë kibernetike, mbrojtjes kibernetike dhe hetimit të incidenteve kibernetike	190 000
6	Specialist në drejtoritë apo sektorët e përmbytjes përgjegjës për funksionet e monitorimit të jashtëm, politikave, çështjeve ligjore, analizës së indikatorëve, statistikave dhe modeleve, komunikimit, ndërgjegjësimit dhe zhvillimeve strategjike	120 000